



Këshilli Drejtues

Nr. ref. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_.

Këshilli Drejtues i Universitetit "Ukshin Hoti" duke u bazuar në dispozitat e Statutit të Universitetit nr. 04-V-621 dhe Rregullores nr. 01-179/A të datës 11.05.2022, mori vendim për të shpallë:

## KONKURS

### Për ndarjen e bursave universitare për vitin akademik 2020/21

Përfitues të bursës universitare do të jenë studentët e Universitetit "Ukshin Hoti" të cilët i plotësojnë kriteret sipas rregullore nr. 01-197/A të datës 11.05.2022 dhe këtij konkursi:

#### I. Kriteret për përfitim të bursës:

- Të jetë student i rregullt i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren;
- Të jetë student i vitit të dytë e më lartë;
- Të mos ketë vit të përsëritur të studimeve;
- Të ketë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak përkatës të studimeve deri në afatin e shtatorit;
- Të ketë notën mesatare së paku:
  - Studentët e Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit dhe Fakultetit të Shkencave Kompjuterike, niveli baçelor - 8.5.
  - Studentët e Fakultetit Juridik, Fakultetit Ekonomik, Fakultetit të Edukimit dhe Fakultetit të Filologjisë, niveli baçelor - 9.0.
  - Studentët e Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit dhe Fakultetit të Shkencave Kompjuterike, niveli master - 8.5.
  - Studentët e Fakultetit Juridik, Fakultetit Ekonomik, Fakultetit të Edukimit dhe Fakultetit të Filologjisë, niveli master - 9.0.

#### II. Dokumentacioni për aplikim:

- Formulari i aplikimit;
- Formulari i deklaratës nën betim;
- Pasqyra e notave;
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Numrin e llogarisë bankare (personale).

#### III. Afati i aplikimit:

Dorëzimi i dokumentacionit bëhet në Fakultetin e Ekonomisë, kati II, zyra nr. 222, në objektet e Universitetit. Afati për aplikim është prej datës 15.06.2022 deri më 30.06.2022.

**IV. Shënim:** Lartësia e bursës do të caktohet me një vendim të veçantë nga Këshilli drejtues si parashihet edhe me dispozitat e nenit 3 të rregullores nr. 01-197.

Formulari për aplikim dhe deklarata nën betim gjenden në faqen zyrtare të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren: <https://www.uni-prizren.com/>